



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



QENDRA
MAQEDONASE PËR
EDUKIM
QYTETAR



Projekt për integrim ndëretnik në arsim

RAPORTI MUJOR

i Projektit të USAID-it për integrimin ndëretnik në arsim

Mars 2014

I. AKTIVITETET E REALIZUARA

Komponenti 1- Informimi i opinionit dhe bashkësisë

- **Organizimi i një forumteatërdebati.** Në mars u organizua një forum teatër për ekipin e Projektit për integrim ndëretnik në arsim (PINA), organizatat partnere, përfaqësuesit e USAID dhe për master trajnuesit që janë përfshirë në projektin konkret. Debati u përdor si një vegël për zhvillimin e një debati dhe zgjidhjen e një situatë konkrete që reflekton gjendjen momentale të sistemit arsimor vendas.
- **Realizimi i dy trajnimeve për përgatitjen e përmbajtjeve multimediale të Internetit në kontekstin e integritimit ndëretnik në arsim.** Në këto trajnime u përfshinë mësimmshënësist dhe nxënësist e shkollave të mesme të rajonit të Shkupit dhe Kavadarit. Aktivitetet e këtyre trajnimeve kanë për qëllim të ndihmojnë mësimmshënësist dhe nxënësist për zhvillimin e aftësive të ndryshme për përgatitjen e përmbajtjeve multimediale të Internetit për nevojat e shkollave të tyre. Këto aktivitetet zhvillohen nën drejtimin e redaktorëve dhe gazetarëve që janë përfshirë në këtë projekt.
- **Debat publik në kuadër të klubit debatues të komunës së Kumanovës.** Me një përbërje etnike të ndryshme, nxënësist që morën pjesë në debat shqyrtuan temën “Objektet me ndarje etnike (nuk) pengojnë integrimin”, ndërsa në kuadër të këtij debati shkëmbyen mendimet dhe qëndrimet e tyre, duke treguar aftësitë e tyre për të debatuar. Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me Organizatën partnere Forumi rinor i arsimit.
- **Organizimi i punëtorive kreative** gjatë muajit Mars, në kuadër të gjashtë shkollave të zgjedhura në komunat e Koçanit, Kavadarit, Gostivarit, Prilepit, Ohrit dhe Shkupit. Këto punëtorit fituan mbështetjen e mësimmshënësive dhe u zhvilluan nën drejtimin e ekspertëve/artistëve që u angazhuan për grupet prej 20-25 nxënës, të cilët ndërtojnë kapacitetet dhe pasurojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për të siguruar një kohezion ndëretnik nëpërmjet metodave dhe qasjeve kreative.
- **Përgatitja e një videoje të shkurtër me nxënësist që morën pjesë në punëtoritë kreative.** Me rastin e 8 Marsit, dita e femrës, PINA përgatiti një video të shkurtër me dy nxënësist të shkollës së mesme “Arseni Jovkov”, nxënësist të përfshira në punëtoritë kreative të kësaj shkolle. Magdalena dhe Artiana në këtë video sqarojnë mënyrën se si janë afruar me ndihmën e procesit dhe përfitimet e procesit. Këtë video mund ta shikoni në linkun në vijim: <https://www.youtube.com/watch?v=WuyZ7KiHGxA>
- **Përgatitja e një videoje të shkurtër me aktivitetet e shkollave partnere.** PINA, në bashkëpunim me Organizatën partnere IMM (Instituti Maqedonas i Mediave), përgatiti një video të shkurtër lidhur me vizitën e shkollës partnere “Marshall Tito” nga Strumica në shkollën fillore “Liman Kaba” në fshatin Luboten, gjatë të cilës u vizituan objektet monumentale fetare dhe historike. Këtë video mund ta shikoni në linkun në vijim: <http://www.youtube.com/watch?v=0yHqfBY8taE>
- **Informimi i rregullt i institucioneve, komunave dhe shkollave lidhur me aktivitetet.** Një pjesë e aktiviteteve të zhvilluara në muajin mars përfshinë edhe azhurnimin e rregullt



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



QENDRA
MAQEDONASE PËR
EDUKIM
QYTETAR



Projekt për integrim ndëretnik në arsim

të informacioneve dhe publikimin e lajmeve dhe rrëfimeve lidhur me rrjedhën e aktiviteteve në ueb faqen e projektit www.pmio.mk. Gjithashtu, botimi i parë i Informatorit medial për nevojat e PINA është përgatitur dhe u është ndarë të gjitha mediave në Maqedoni.

Komponenti 2 – Ndërtimi i kapaciteteve të drejtuesve të shkollave dhe mësimitdhënësve

- **Revizioni i modulit bazë.** Është reviduar moduli bazë në të cilin janë dhënë aktivitete praktike dhe një prezantim me video në të cilin mund të gjenden shembuj të suksesshëm nga praktika, që kanë të bëjnë me avancimin e integritit ndëretnik në arsim. Gjithashtu është mundësuar edhe një sesion për ndjekjen e aktiviteteve të integritit ndëretnik në arsim në nivel shkolle dhe janë ndryshuar plani vjetor dhe plani i aktiviteteve konkrete të integritit ndëretnik në arsim.
- **Punëtori njëditore me master trajnues për mbështetjen mentoriale.** Ky aktivitet ka pasur për qëllim zhvillimin e shkathtësive të master trajnuesve lidhur me mënyrën e drejtimit, me ndihmën e përdorimit të teknikave dhe zbatimit të strategjive lidhur me mundësimin e informacioneve kthyesë për aktivitetet e përbashkëta të nxënësve me përbërje të përzier etnike. Me këtë rast një sesion i veçantë u zhvillua për takimet e drejtuesve që do të mbahen me përfaqësuesit e shërbimeve profesionale, këshillave të shkollave dhe personave përgjegjës për arsimin në kuadër të komunave. Gjithashtu, është zhvilluar edhe një sesion për monitorimin e PINA në shkollat e Fazës 2.
- **Trajnimet e ekipeve për integrim shkollor të Fazës 3.** Gjatë këtij muaji u realizuan 16 grupe të trajnimeve për nevojat e ekipeve për integrimin shkollor në shkollat e përfshira në Fazën 3. Qëllimi kryesor i këtyre trajnimeve ka qenë njohja e pjesëmarrësve me konceptin e integritit ndëretnik në arsim, i cili promovon modelin e arsimit që u mundëson nxënësve aktivitete të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore, që duhen zhvilluar në grupe nxënësish me përbërje të ndryshme etnike dhe gjuhësore.
- **Përshtatja e instrumenteve të Rregullores për vlerësimin integral me ekipin e inspektorëve shtetëror të arsimit.** Me këtë aktivitet u mundësua përfshirja e elementeve të integritit ndëretnik në instrumentet përkatëse që përdoren për vlerësimin integral.
- **Plani aksionar i detajuar lidhur me aktivitetet e ardhshme të Fakulteteve për arsimtarë,** në bashkëpunim me Organizatën partnere “Loja”. Me këtë rast u zhvillua një takim me prodekanët e Fakultetit pedagogjik “Shën Klimenti i Ohrit” në Manastir, lidhur me aktivitetet e planifikuara të PINA dhe pjesëmarrjen e profesorëve në Konferencën rajonale për përfshirjen e programeve të “Arsimit për paqe” në nivel universitar. Prodekanët ranë dakord me aktivitetet e planifikuara dhe propozuan pjesëmarrësit e tyre.
- **Punëtori dyditore për trajnimin e mësuesve – trajnuesve për aktivitetet e përbashkëta sportive dhe argëtuese për/me nxënësit.** Në trajnimet që u zhvilluan në Strugë morën pjesë ekipet përgjegjëse të mësimitdhënësve të dhjetë shkollave fillore që mbajnë arsim në disa gjuhë. Qëllimi i trajnimeve ka qenë njohja e mësimitdhënësve – trajnuesve midis tyre dhe ballafaqimi në praktikë me teknikat dhe qasjet lidhur me zbatimin e konceptit të integritit ndëretnik në arsim, nëpërmjet aktiviteteve sportive dhe argëtuese me nxënësit.

Komponenti 3 – Shkollat model

- **Takime për përkrahje.** Katër takime të ndryshme për mbështetje u realizuan në shkollat shumëgjuhëshe model nga ana e ekipit të PINA. Në fokusin e këtyre takimeve u gjetën ndjekja e aktiviteteve dhe zhvillimi i bisedave me realizuesit e aktiviteteve dhe personave përgjegjës të ekipeve për integrimin shkollor. Gjatë takimeve u diskutua edhe mënyra e sigurimit të një cilësie më të mirë të aktiviteteve nga aspekti i realizimit të integritit



Projekt për integrim ndëretnik në arsim

ndëretnik. Ndërkohë nga realizuesit u kërkuar të sigurojnë sa më shumë përmbajtje multimediale, që me ndihmën e tyre të përgatiten ngjarjet promovuese përmbyllëse.

- **Pilotim i punëtorive për njohtim të gjuhëve.** Gjatë këtij muaji Shkolla fillore “Petar Zdarvkovski PENKO” në Shkup u përfshi në realizimin e programit për organizimin e punëtorive për njohtim të gjuhës. Me këtë rast u formuan dy grupe me nga njëzetë nxënës që mësojnë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe. Ndërkohë, u zhvilluan katër punëtori, nga dy me secilin grup. Punëtoritë organizohen nga ana e ekipit të Qendrës së të Drejtave të Njeriut dhe Zgjidhjes së Konfliktëve (QDNJZK), ndërsa në realizimin e tyre morën pjesë edhe bashkëpunëtorë të jashtëm.
- **Manifestime në shkollat model.** Në Mars u organizuan katër manifestime të ndryshme, dy në Shkollën fillore “Bratstvo Edinstvo” në Ohër dhe dy të tjera në shkollat e mesme në Gostivar dhe Shkup. Në Ohër njëri nga manifestimet u zhvillua me rastin e 7 Marsit – Ditës së mësuesit shqiptar, ndërsa manifestimi tjetër u zhvillua me rastin e 8-Marsit – Ditës së femrës. Ndërkaq, dy manifestimet në Gostivar dhe Shkup u zhvilluan me rastin e Ditës së mësuesit shqiptar. Në kuadër të këtyre manifestimeve u zhvilluan performime të ndryshme të integruara, që u përgatitën dhe u realizuan nga ana e nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme.
- **Iniciativat e prindërve.** Në Mars, me iniciativën e prindërve, u zhvilluan disa aktivitete. Në Shkollën fillore “Bratstvo Edinstvo” në Ohër nga ana e prindërve u organizua festimi i manifestimit “Letnik” (14 mars), në të cilin morën pjesë mësues, nxënës dhe përfaqësues të Komunës së Ohrit. Në Shkollën fillore “Sande Shterjoski” në Kërçovë një grup prindëresh, fëmijët e të cilëve mësojnë në gjuhë të ndryshme, bashkë me nxënësit, morën pjesë në përgatitjen e dekorimeve të ndryshme me letër me rastin e Ditës së verës. Në Shkollën e mesme të ndërtimit “Zdravko Cvetkovski” në Shkup u organizua mbjellja e trëndafilave në oborrin e shkollës. Në këtë aktivitet morën pjesë shumë prindër, mësime dhe nxënës. Në Shkollën e mesme ekonomike në Gostivar prindërit organizuan një turnir futbolli. Ekipi i prindërve me këtë rast luajti me ekipin e nxënësve. Në përbërjen e dy ekipeve morën pjesë nxënës të përkatësive të ndryshme etnike.
- **Aktivitetet e bashkësive të shkollave.** Në Shkollën fillore “Bratstvo Edinstvo” në Ohër, me ndihmën e kryesisë së bashkësisë së shkollës, u organizuan dy aktivitete. Në njërin rast u organizua një manifestim për të gjithë nxënësit e shkollës. Çmimi i biletës për pjesëmarrje në këtë manifestim ishte simbolik, ndërsa mjetet e siguruarat me biletat do të investohen për nevojat e shkollës. Gjithashtu u organizua edhe një ndeshje sportive, në të cilën morën pjesë dy ekipe nxënësish që mësojnë në gjuhë të ndryshme.
- **Punëtori me ekipeve për integrimin shkollor të shkollave partnere model.** Për zhvillimin e një strategjie për realizimin e mëtejshëm të aktiviteteve të projektit, përfaqësues të dy shkollave nga Kumanova, në praninë e këshilltarëve të Byrosë së Zhvillimit të arsimit, morën pjesë në punëtorinë gjatë të cilës u shqyrtuan efektet e aktiviteteve projektuese. Me këtë rast u shqyrtuan disa ide për siguri më të madhe të fëmijëve të dy shkollave dhe u caktua një takim i Këshillit të prindërve, gjatë të cilit do të sqarohen idetë e ofruara.

Komponenti 4 – Sigurimi i nxitjes për shkollat dhe bashkësitë

- **Zgjedhja e 10 shkollave.** Një grup pune shqyrtoi aplikimet e pranuarat të 99 shkollave dhe me përmbledhjen e rezultateve të tyre u përgatit një listë me 10 shkolla që do të përfshihen në aktivitetet e komponentit në fazën 3.



Projekt për integrim ndëretnik në arsim

Shkollat e zgjedhura të komponentit 4 – faza 3					
1	Pellagoni	Prilep	Topollčanë	Shkolla fillore	Krume Volnaroski
2	Shkup	Kisella Vodë	Draçevë	Shkolla fillore	Kuzman Shapkarev
3	Pollog	Gostivar	Çajle	Shkolla fillore	Çajla
4	Pellagoni	Krivogashtani	Obrshanë	Shkolla fillore	Jonçe Smugreski
5	Shkup	Gjorçe Petrov	Shkup	Shkolla fillore	Gjorçe Petrov
6	Shkup	Ilinden	Ilinden	Shkolla fillore	Goce Dellçev
7	Pellagoni	Krushevë	Krushevë	Shkolla e mesme	Naum Naumovski Borçe
8	Juglindje	Bogdancë	Bogdancë	Shkolla mesme	Bogdancë
9	Pollog	Vrapçishtë	Vrapçishtë	Shkolla fillore	Vrapçishtë (Çede Filiposki)
10	Jugperëndim	Dibër	Kosovrasti i Poshtëm	Shkolla fillore	Riste Ristevski

Të gjitha shkollave dhe komunave që aplikuan u janë dërguar njoftime me shkrim lidhur me rezultatet e zgjedhjes. Listën e 10 shkollave të zgjedhura mund ta shikoni në linkun në vijim: <http://pmio.mk/news/>.

- **Formimi i ekipeve për rinovim të shkollave (ERSH).** Në 10 shkolla, 8 të fazës 3 dhe 2 shkolla model, janë zhvilluar takimet e para në praninë e ekipit të Komponentit 4, ndërsa në 6 shkolla të tjera janë zhvilluar edhe takimet e dyta në kuadër të cilave janë formuar ekipet për rinovim të shkollave. Ekipet për rinovim të shkollave përbëhen nga 5-8 anëtarë, përfaqësues të të gjitha bashkësive, të cilët në fakt pasqyrojnë përbërjen e popullatës së vendit në të cilin funksionon një shkollë konkrete.
- **Pjesëmarrje e komunave dhe shkollave në procesin e rinovimit.** Në vazhdim e sipër është procesi i dokumentimit të pjesëmarrjes së komunave dhe shkollave në aktivitetet e rinovimit, pjesëmarrje kjo që duhet të sigurojë dhjetë përqindëshin e nevojshëm.

Monitorimi dhe vlerësimi

- **Aktivitetet për monitorim.** Në kuadër të këtij aktiviteti u siguruan të dhënat e nevojshme dhe u përgatit raporti i monitorimit të aktiviteteve të të gjitha shkollave pilot. Me këtë rast u zhvillua një takim i përbashkët dhe disa takime të tjera me përfaqësuesit e organizatave partnere që morën pjesë në monitorimin e aktiviteteve, lidhur me të dhënat e fituara nga monitorimi. Përgatitjet e monitorimit të aktiviteteve të shkollave të Fazës 2 janë në vazhdim e sipër.
- **Aktivitetet për vlerësim.** Përgatitjet për zhvillimin e analizave në terren janë në vazhdim e sipër (vlerësimi i efekteve të aktiviteteve lidhur me Integrimin ndëretnik në arsim dhe grupet qëllimore të nxënësve).
- **Studimi i gjendjes fillestare.** Vazhdon procesi i përgatitjes së aplikacionit elektronik për analizim elektronik.



Projekt për integrim ndëretnik në arsim

II. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN QË VIJON

Komponenti 1 – Informimi i opinionit dhe bashkësivë

- Takim me ekipin që do të merret me dokumentarin edukativ “7x7”, në bashkëpunim me Institutin maqedonas të mediave dhe Radio televizionin e Maqedonisë.
- Trajtime për mësimdhënësit dhe nxënësit në Prilep, Koçanë dhe Shkup lidhur me prodhimin e përmbajtjeve multimediale të Internetit.
- Forum teatër debat për mësimdhënësit pjesëmarrës të trajnimeve për integrim ndëretnik në arsim.
- Takime joformale me redaktorë dhe gazetarë.
- Azhurnim i rregullt i informacioneve dhe publikimi i risive dhe tregimeve për rrjedhën e aktiviteteve përmes ueb faqes së projektit www.pmio.mk.

Komponenti 2 – Ndërtimi i kapaciteteve të drejtuesve të shkollës dhe mësimdhënësve

- Trajtime një dhe dy ditore të ekipeve për integrimin shkollor të përfshira në Fazën 3 ;
- Takime mentoriale me përfaqësuesit e shërbimeve profesionale, këshillat shkollor dhe punonjësve përgjegjës për fushën e arsimit në kuadër të komunave;
- Përkrahje të Loja gjatë organizimit të Konferencës rajonale për përfshirje të programeve për Arsim për paqe në nivel universitar. Pas mbarimit të konferencës do të mbahet një takim pune me pjesëmarrësit e fakulteteve pedagogjike lidhur me strukturimin e detajuar të aktiviteteve që kanë të bëjnë me përgatitjen e doracakut dhe përfshirjen e konceptit për Integrimin ndëretnik në arsim në programet mësimore;
- Vizita për mbështetjen e 10 shkollave në të cilat mësimi zhvillohet në disa gjuhë, lidhur me organizimin e aktiviteteve të përbashkëta sportive dhe argëtuese me nxënësit.

Komponenti 3 – Shkollat model

- Zhvillimi i takimeve për monitorim dhe mentoriale për përkrahjen e çdo shkolle model.
- Organizimi dhe zhvillimi i punëtorive plotësuese për njohtimin e gjuhës.
- Përkrahje e vazhdueshme gjatë realizimit të aktiviteteve të tanishme të shkollave.

Komponenti 4 – Sigurimi i nxitjes për shkollat dhe bashkësite

- Formimi i ekipeve për rinovim të shkollave (ERSh). Në tre shkolla, dy të fazës 3 dhe një tjetër shkollë model, do të zhvillohen takimet e para në praninë e ekipit të Komponentit 4, ndërsa në shtatë shkolla të tjera do të mbahen takimet e dyta, në kuadër të të cilave do të formohen ekipe për rinovimin e shkollave.
- Organizimi i trajnimeve për nevojat e ekipeve për rinovimin e shkollave. Në shkollat e Fazës 3 do të organizohen trajnime për t'u definuar nevoja e rikonstruimit dhe trajnime lidhur me përgatitjen e një aplikacioni dhe definimin e buxhetit të rikonstruimit;
- Pranimi teknik i aktiviteteve që kanë të bëjnë me ndërtimin e një hyrjeje kryesore në shkollën fillore “Nikolla Karev” në komunën e Koçanit, me mbështetjen financiare të Ministrisë së arsimit dhe shkencës.
- Takime në nivel mujor lidhur me kontrollimin e punëve që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e 11 shkollave të Fazës 2.
- Dokumentimi i pjesëmarrjes së komunave dhe shkollave në aktivitetet e rinovimit.

Monitorimi dhe vlerësimi

- Monitorimi i aktiviteteve të realizuara sipas komponentëve.
- Finalizimi i raportit nga monitorimi i aktiviteteve dhe përpilimi i një raporti të kombinuar me



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



QENDRA
MAQEDONASE PËR
EDUKIM
QYTETAR



Projekt për integrim ndëretnik në arsim

- raportin e vlerësimit.
- Përgatitja e një aplikacioni për analiza elektronike dhe për monitorimin e aktiviteteve të shkollave të Fazës 2.
- Përgatitja e pyetësorëve lidhur me vlerësimin e aktiviteteve të projektit.